Shkoi të mjekohet pasi u plagos me armë zjarri, i riu në Elbasan arrestohet pasi nuk tregoi rrethanat e ngjarjes

31 Dhjetor, 2022 16:15

Madhësia e tekstit:

Një i ri ka shkuar ditën e sotme për tu mjekuar në spitalin e Elbasanit pasi ishte plagosur me armë zjarri, ndërsa është arrestuar për shkak se nuk ka treguar rrethanat e ngjarjes.

Sipas njoftimit të policisë, i riu i plagosur në këmbë është arrestuar së bashku me dy shokët e tij të cilët po ashtu nuk kanë treguar çfarë ka ndodhur me të.

Fatmir Murati 35 vjeç, dhe miqtë e tij Sh. H., 33 vjeç dhe M. G., 30 vjeç, të tre banues në lagjen "5 Maji", u arrestuan pasi giatë marrjes në pyetje nga grupi hetimor, Murati ka deklaruar se ishte dëmtuar me një hekur, pasi ishte rrëzuar nga motori

Njoftimi i policisë:

Elbasan

Shkoi për mjekim në spital, i dëmtuar në këmbë, dyshohet me armë zjarri, dhe nuk tregoi rrethanat e ngjarjes, arrestohet në flagrancë nga Policia.

Në pranga edhe 2 shtetas të tjerë (shokët e tij), për moskallëzim krimi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Elbasan arrestuan në flagrancë shtetasit:

F. M., 35 vjeç, Sh. H., 33 vjeç dhe M. G., 30 vjeç, të tre banues në lagjen "5 Maji", Elbasan.

Më datë 30.12.2022, rreth orës 21:30, ka shkuar për mjekim në spitalin rajonal të Elbasanit, shtetasi F. M., me një plagë në këmbë, e dyshuar e shkaktuar nga një armë zjarri. Pasi ka marrë mjekim, ky shtetas ka dalë nga spitali.

Gjatë marrjes në pyetje nga grupi hetimor, shtetasi F. M. ka deklaruar se ishte dëmtuar me një hekur, pasi ishte rrëzuar nga motori, në vendin e quajtur "Harqet".

Shërbimet e Policisë kanë shoqëruar edhe shtetasit Sh. H. dhe M. G., shokë të shtetasit F. M., të cilët gjatë marrjes në pyetje nuk kanë treguar rrethanat e vërteta të ngjarjes.

Grupi hetimor nuk ka gjetur asnjë send të kundraligishëm, giatë kontrollit në vendin e ngjarjes të pretenduar nga 35-vjeçari.

Nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan vijon puna për zhardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e personave të përfshirë në këtë ngjarje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale "Moskallëzimi krimit" dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës".

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

BW | GET IT ON Google Play

Kerko keto

LAJMET E FUNDIT

Ndryshime konkrete jo vetëm në punë, çfarë do të ndodhë në 2023? Horoskopi vjetor i Shigjetarit
01 Janar, 2023

Nga të fshehtat personale te krahasimet e politikanëve me kafshët, intervista humoristike e Sali Berishës zbulon gjithçka
01 Janar, 2023

Parashikimi për dashurinë, punën dhe shëndetin, si do të jetë viti 2023 për Akrepët
01 Janar, 2023

Messi kundër Ronaldos, duel në janar? Mësheurja ali po e presin të gjithë në Arabinë Saudite
01 Janar, 2023

Ku priteet të jetojë Cristiano Ronaldo në Arabinë Saudite, shtëpia me dhomë pritjeje me sipërvarë që kushton 14 mln euro
01 Janar, 2023

Aksi Korçë-Pogradec mbulohet nga mjegulla e dendur, shoferët detyrohen të ulin shpejtësinë
01 Janar, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

TË NGJASHME

Ndryshime konkrete jo vetëm në punë, çfarë do të ndodhë në 2023? Horoskopi vjetor i Shigjetarit
01 Janar, 2023

Nga të fshehtat personale te krahasimet e politikanëve me kafshët, intervista humoristike e Sali Berishës zbulon gjithçka
01 Janar, 2023

Taboola Feed

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
Play for free. No Install.
CombatSurge · Sponsored

Babbel: Getting You Speaking A New Language This Year
Babbel · Sponsored
Learn More


Lajm i mirë për pensionistët, ja sa shpërblim do të marrin në fundvit. Kategoritë e tjera që përfitojnë
Lajm i mirë për pensionistët, ja sa shpërblim do të marrin në fundvit. Kategoritë e tjera që përfitojnë
balkanweb.com

Our tips for reigniting your passion for language learning
Babbel · Sponsored
Learn More

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Lushnje/ Autobusi shpërthen në flakë, shoferi nxjerr menjëherë jashtë pasagjerët
01 Janar, 2023

U vetëplagos aksidentalisht me pistoletë, i riu në Shkodër merr plumbin në këmbë gjatë ndërlimit të viteve
01 Janar, 2023

Ndërroi jetë pas zjarrit masiv në godinën ku jetonte, kush është adoleshenti shqiptar që jetonte i vetëm prej vitesh në Itali
01 Janar, 2023

Në kërkim për trafik narkotikësh, arrestohet 66-vjeçari në Gramsh(Emri)
01 Janar, 2023

Zjarr i madh në tregun industrial të Durrësit, shkrumbohen pesë dyqane
01 Janar, 2023

Vret veten me armë zjarri 42-vjeçari në Dibër, detajet e para
01 Janar, 2023

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Kievi mirëpret Vitin e Ri në errësirë, gytetarët ukrainas brohoraisin nga ballkonet
01 Janar, 2023

Tragjedi në Ugandë, 9 të vrarë pas një shfaqjeje me fishekzjarre gjatë festimeve të Vitit të ri
01 Janar, 2023

Presidenti Begaj bisedë me FA në mision jashtë vendit: Do vijojmë të kontribuojmë në mënyrë aktive në operacione të NATO-s
01 Janar, 2023

Kroacia hyn në Eurozonë dhe Shengen, ndryshon monedhën në Euro
01 Janar, 2023

Qindra gytetarë në shesha dhe spektakël fishekzjarresh, ja si u prit ardhja e vitit të ri në qytete të ndryshme të vendit
01 Janar, 2023

Një vajzë dhe një djalë, dy filmjët e parë të vitit 2023 në Shqipëri
01 Janar, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.